



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr.13

Prishtinë, më 27.3.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Adem Mikullovc, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekalju, Nezir Çoçaj dhe Abdyl Salihu.

Munguan: Arbërie Nagavci, Albulena Balaj-Halimaj dhe Verica Qeraniq.

Përfaqësues të tjerë: Përfaqësues të KDI-së dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky :

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.2.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.2.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 14.2.2018 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Ismajl Kurteshi, kryetar, në fillim të mbledhjes propozoi që, në kuadër të Komisionit, të formohen grupe punuese në lidhje me shqyrtimin e mëtejme të projektligjeve që janë në procedurë.

Anëtarët e Komisionit përkrahën idenë e themelimit të grupit punues për shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës në këtë përbërje: Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu, Valentina Bunjaku Rexhepi, Nezir Çoçaj dhe Muferra Shiniq. Grupit punues mund t'i bashkëngjiten edhe anëtarët e tjerë që sot nuk janë prezent në mbledhje.

Sa i përket formimit të Grupit të punës për Projektligjin për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë u theksua se i njëjti do të formohet së shpejti, si dhe për këtë do të mbahet një dëgjim publik.

Komisioni, në lidhje me Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, në bashkëpunim dhe përkrahje të KDI-së, sot më datë 27 mars 2018, me fillim në orën 11:00, në hotel „SIRIUS” në Prishtinë, do të mbajë dëgjim publik, ku janë ftuar përfaqësues të institucioneve, ekspertë dhe grupet e interesit, për t'i dhënë vërejtjet dhe rekomandimet e tyre për këtë projektligj.

Gjithashtu, në këtë dëgjim publik do të bëhet prezantimi i hulumtimit të bërë nga KDI në lidhje me Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit.

Ismajl Kurteshi i njoftoi anëtarët e Komisionit në lidhje me vizitën studimore, të mbështetur nga GIZ-i, të disa anëtarëve të Komisionit që pritet të realizohet në Slloveni në fund të muajit prill, me qëllim të marrjes së informacioneve për këtë projektligj, andaj kërkoi që në këtë vizitë të marrin pjesë një numër i caktuar i anëtarëve të Komisionit nga subjektet e ndryshme politike.

4. Të ndryshme

Ismajl Kurteshi, për këtë pikë të rendit të ditës i njoftoi anëtarët e Komisionit me kërkesën e Forumit kosovar për fëmijët me nevoja të veçanta dhe kërkoi që për këtë kategori të organizohet një dëgjim publik.

Teuta Haxhiu, tha se si Komision do duhej që, përmes një shkrese, t'i bëjmë presion Qeverisë dhe të kërkojmë që sa më shpejt të procedohet në Kuvend Projektligji për mësimdhënësit e viteve të 90 –ta.

Sa i përket kategorisë tjetër të mësimdhënësve, të cilët për shkaqe shëndetësore nuk mund të marrin pushime mjekësore, kurse janë të detyruar të punojnë, tha se është i nevojshëm të iniciohet hartimi i Projektligjit për këtë kategori të punëtorëve arsimor, si dhe të njoftohet MASHT-i dhe MPMS-ja për dalje nga kjo situatë.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që, në njërën nga mbledhjet e ardhshme, të ftohen ministri i MASHT-it si dhe ministri i MPMS-së, për t'i diskutuar këto çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Ismajl Kurteshi